



Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

MBI MIRATIMIN E MODELEVE TË NJË PJESE TË DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR QË I DËRGOHET ZGJEDHËSIT NGA JASHTË PËR PROCESIN ZGJEDHOR TË VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2 të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ – së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë tjetër që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 24, pika 1 parashikon kompetencën e KQZ-së lidhur me votimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Aty parashikohet se KQZ-ja drejton, mbikëqyr dhe është përgjegjëse për procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave, që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin.

Neni 25 parashikon mënyrën e votimi të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, administrimin e materialit zgjedhor të nisur nga këta zgjedhës, si dhe nxjerrjen e rezultatit zgjedhor.

Neni 99 e vijues i Kodit Zgjedhor parashikon rregullat lidhur me dërgimin e materialeve zgjedhore nga KQZ-ja, duke listuar të gjithë materialet zgjedhore që dërgohen dhe përdoren nga KQV-të deri në nxjerrjen e rezultatit zgjedhor, pjesë të të cilave janë edhe materialet e parashikuara në lidhjen 1 të këtij vendimi.

Vendimi nr. 13, datë 12.11.2024 i Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, në kreun III, nënkreu III.I, me titull “Rregulla të posaçme” parashikohet dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë vendit, që janë: fleta e votimit, zarfi ku futet fleta e votimit, materiali udhëzues që përmban sqarime për zgjedhësin për plotësimin e fletës së votimit, për procedurat e dërgimit mbrapsht të fletës së votimit nga zgjedhësi në KQZ, zarfi i jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim përcaktimin e rregullave për përdorimin e një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë, si dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit.

Në Aneksin 1 dhe Aneksin 2 bashkëlidhur këtij projektvendimi renditet një pjesë e dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë, përdorueshmëria e tyre, si dhe karakteristikat e përgjithshme dhe të veçanta të tyre.

- Projektvendimi liston si pjesë të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë zarfin ku futet fleta e votimit, i cili është në përmasa dhe në ngjyrë të njëjtë për të gjithë zgjedhësit.

Zarfi ku futet fleta e votimit është zarfi i brendshëm. Zarfi i fletës së votimit, i cili përmban vetëm fletën e votimit, vendoset në zarfin e jashtëm të dërguar tek zgjedhësi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas parashikimeve të kreut III.1. Mbi këtë zarf KQZ do të vendosë/ngjisë Kodin Unik të regjistrimit të çdo zgjedhësi në PER. Kodi Unik i zgjedhësit gjenerohet automatikisht nga PER dhe përmban emër, mbiemër të zgjedhësit, shtetin ku ka kërkuar t’i dërgohet fleta e votimit, si dhe qarkun ku ka regjistruar e gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë. Kodi Unik i zgjedhësit është gjithashtu i pasqyruar në formën e një Barcode, ose QR Code. Pasi gjenerohet nga PER, Kodi Unik bëhet i disponueshëm për çdo zgjedhës nga jashtë vendit. Në momentin që zgjedhësit i mbërrin në adresën e deklaruar jashtë vendit zarfi i dërguar nga KQZ, zgjedhësi do të konfirmojë në PER marrjen në dorëzim të zarfit.

- Në projektvendim listohet si pjesë e dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësi nga jashtë zarfin e jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit.

Zarfi i jashtëm mbi të cilin është vendosur Kodi Unik i zgjedhësit i cili ka brenda zarfin që mban fletën e votimit, futet në zarfin e operatorit të shërbimit postar dhe postohet për në adresën e KQZ.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Mbi miratimin e modeleve një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë për procesin zgjedhor të votimit nga jashtë vendit”.

Jona JOSIFI - Drejtorja e Votimit nga Jashtë

Pavlina DOÇAJ – Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data

Nr:

Ora:

VENDIM

MBI

MIRATIMIN E MODELEVE TË NJË PJESE TË DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR
QË I DËRGOHET ZGJEDHËSIT NGA JASHTË PËR PROCESIN ZGJEDHOR TË
VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 24 pika 1, nenit 25/1 dhe të nenit 99 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.13, datë 12.11.2024 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

- Miratimin e modeleve të një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë, në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor për votimin nga jashtë vendit, si më poshtë vijon:
 - “Zarfi ku futet fleta e votimit”;
 - “Zarfi i jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit”.
- Modelet e zarfeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi pasqyrohen në lidhjen 1 “Zarfi i brendshëm” dhe në lidhjen 2 “Zarfi i Jashtëm”.
- Përcaktimi i sasive të modeleve të zarfeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe i kriterëve dhe specifikimeve teknike, veçmas atyre që përmban lidhja 1 dhe lidhja 2, bëhet në përputhje me parashikimet e legjisllacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
- Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data:

Nr:
Ora:



“Mbi miratimin e modeleve të një pjese të dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë për procesin zgjedhor të votimit nga jashtë vendit”